



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 10, datë 28 .02. 2013

**P Ë R**

**“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 43, DATË 20.11.2012 PËR “MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN E SUBVENCIONIMIT TË FAMILJEVE QË PËRFITOJNË KREDI TË LEHTËSUARA NGA SHTETI, SISTEMIN E PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA DHE SISTEMIN E PIKËZIMIT PËR BONUSIN E STREHIMIT”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 1, neni 10, pika 3/I, shkronja “g”, neni 32, shkronja “k” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); neni 3, pikat 1 dhe 2, neni 4, pikat 1, 2 dhe 3, neni 5, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004 për “Programet sociale të strehimit” (i ndryshuar); neni 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); pika 6 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 574, datë 29.08.2012 për “Përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”; të udhëzimit nr. 6257, datë 02.09.2008 mbi “Përcaktimin e masës së subvencionimit për familje që përfitojnë kredi të lehtësuar nga shteti”, (i ndryshuar); vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 63, datë 08.11.2005, “Për miratimin e komisionit të strehimit” (i ndryshuar), ju paraqesim për shqyrtim materialin e mëposhtëm:

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, shkronja “b” (tabela II- sistemi i pikëzimit për programin e banesave sociale me qira) të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 43, datë 20.11.2012 për “Miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e subvencionimit të familjeve që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti, sistemin e pikëzimit për programin e banesave sociale me qira dhe sistemin e pikëzimit për bonusin e strehimit”, si më poshtë:

**TABELA II - SISTEMI I PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA**

	<b>KRITERET E PIKËZIMIT</b>	Pikët
<b>1.1</b>	<b>KUSHTET E STREHIMIT</b>	<b>30</b>
<b>A</b>	Familje që përfitojnë nga ligji nr. 82/2012 “për miratimin e aktit Normativ nr. 3, datë 01.08.2012, “Për lirimin e e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarë të pastrehë banues në banesat ish- pronë e subjekteve të shpronësuara”	20
<b>B</b>	Nuk disponon apartament në pronësi	3

C	Banojnë në banesa në rrezik shembje	2
Ç	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	2
D	Kanë ngelur ose rrezikojnë të ngelen të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore, ose zbatimit të një vendimi gjyqësor;	3
<b>1.2</b>	<b>KUSHTET FAMILJARE</b>	<b>20</b>
A	Të moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar nga institucionet publike të përkujdesit shoqëror	5
B	Familjet me më shumë se katër fëmijë ose familje një prindërore	5
C	Familjet e policëve të rënë në detyrë	5
D	Komuniteti Rom dhe Egjipian	5
<b>1.3</b>	<b>KUSHTET SOCIALE</b>	<b>20</b>
A	Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave për këto kategori;	10
B	Persona me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesit shoqëror e deri në moshën 30 vjeç	5
C	Emigrant i kthyer, punëtor emigrant	2
Ç	Viktima të dhunës në familje	3
<b>1.3</b>	<b>KUSHTET EKONOMIKE</b>	<b>30</b>
A	Kufiri maksimal i të ardhurave deri 75% e të ardhurave mesatare kombëtare	5
B	Kategoria 2 (niveli mesatar)	10
C	Kategoria 3 (niveli minimal)	15

2. Ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimeve Sociale, për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

**Niazi KOSOVRASTI**